VENDIM
Nr. 133, datë 6.4.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 22, DATË 30.3.2018, "PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME RROGOZHINË"

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (VKM-ja nr. 958); si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, (Rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 6.4.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e projektvendimit 'Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 22, datë 30.3.2018, 'Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Rrogozhinë"",

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Rrogozhinë (UK Rrogozhinë), me shkresën nr. 34 prot., datë 11.3.2021, me lëndë "Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit ligjor të sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Rrogozhinë", dhe shkresën nr. 45 prot., datë 23.3.2021, me lëndë "Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit teknik të sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Rrogozhinë", ka paraqitur pranë ERRU-së kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe të drejtuesit teknik, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe rregullores së licencimit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Rrogozhinë, për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.
3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Rrogozhinë me vendimin nr. 22, datë 30.3.2018, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Rrogozhinë", me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.
4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Rrogozhinë sh.a., z. Elis Kacani, ka mbaruar studimet e larta në Juridik.
5. Drejtuesi teknik i shoqërisë UK Rrogozhinë sh.a., z. Geraldo Gjini, ka mbaruar studimet e larta Master Profesional në Inxhinierin Hidroteknike, në vitin 2015.
6. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës, për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe të drejtuesit teknik, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Rrogozhinë sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe të rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Rrogozhinë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit të KKRR-së nr. 22, datë 30.3.2018, "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Rrogozhinë" bëhen këto ndryshime:

"Drejtues ligjor: Elis Kacani"

"Drejtues teknik: Geraldo Gjini"

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani